



PRANUAR MË:

ACCEPTED ON:

PRILJENO:

Priljeva:

07/03/2025

02/44



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Kuvendi Komunal Malishevë

PROCESVERBAL

i mbledhjes së -VII- (shtatë) të rregullt të Kuvendit Komunal të Malishevës

REND I DITËS

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së dytë të rregullt e mbajtur me datë: 29.02.2024, procesverbalit të mbledhjes së tretë të rregullt e mbajtur me datë: 12.03.2024, procesverbalit të katërt e mbajtur me datë: 30.05.2024, procesverbalit të pestë të mbajtur me datë: 13.06.2024, procesverbalit të gjashtë të rregullt e mbajtur me datë: 03.09.2024, procesverbalit të mbledhjes së parë të jashtëzakonshme e mbajtur me datë: 28.06.2024, mbledhjes së dytë të jashtëzakonshme e mbajtur me datë: 29.07.2024, mbledhjes së parë urgjente e mbajtur me datë: 28.06.2024 dhe mbledhjes së dytë urgjente e mbajtur me datë: 28.09.2024.
2. Shqyrtimi i raportit të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën Janar- Shtator 2024.
3. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të Komunës së Malishevës për vitin financiar të përfunduar më 31 dhejtor 2023.
4. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/429 datë: 29.10.2024 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës publike, konform vendimit të Kuvendit nr.02/121 datë: 08.03.2024.
5. Shqyrtimi dhe miratimi i listës së pronave të paluajtshme të Komunës.

6. Shqyrtimi dhe miratimi i planit Komunal për menaxhimin e mbeturinave.
7. Shqyrtimi dhe miratimi i draft-Rregullores për Transparencë në Komunën e Malishevës për vitin 2025.
8. Formimi i komisionit për hartimin e planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2025.
9. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/942 datë: 12.08.2024 e parashtruar nga Kryetari i Komunës.
10. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/423 datë: 24.10.2024 për ndërrim destinim të tokës bujqësore
11. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/465 datë: 28.09.2023 për ndërrim destinim të tokës bujqësore
12. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.06/299 datë: 05.12.2022 për ndërrim destinim të tokës bujqësore
13. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/430 datë: 04.11.2024.
14. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/215 datë: 28.05.2024.
15. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/436 datë: 06.11.2024.
16. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/169 datë: 03.04.2024.
17. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/986 datë: 05.09.2024.
18. Të ndryshme.

Mbledhja u mbajtë me datë:27.12.2024 dhe filloi në ora: 10:45. Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin: 27 asambleistë, Drejtori për bugjet dhe financa Blerim Thaçi, Drejtori i shërbimeve publike Rifat Mazreku, Drejtori inspektoriatit Hafir Rexha, Drejtori për urbanizëm Avdi Morina dhe zyra për informim. Mbledhjen e kryesoi Kryesusi i Kuvendit Komunal të Malishevës z. Argjend Thaçi.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Përshëndetje për të gjithë!

Mirë se keni ardhur në mbledhjen e shtatë të rregullt të Kuvendit të Malishevës. Prezent jemi 27 anëtar, kemi kourum dhe mund të vazhdojmë me punimet e mbledhjes.

Meqenëse jemi në mbledhjen e fundit për këtë vit, ju uroj festat e fundvitit juve dhe të gjithë qytetarëve të Komunës së Malishevës, po ashtu bashkëatëdhetarëve pushime të mira pranë familjes dhe në vendlindjen e tyre.

A keni diqka jashtë rendit të ditës për të diskutuar. Urdhëro Mirëllinda Gashi!

Mirëllinda Gashi (anëtare nga PDK): Siç i keni parë zhvillimet e fundit që kanë ndodhur, unë nga sot jam këshilltare komunale e panvarur.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Driton Kastrati!

Driton Kastrati (anëtar nga LDK): Dua të ndërlihem kryesisht me shpenzimet e parasë Komunale, parasë publike në këto vitet e fundit. Dua të ju kujtojë që para dy viteve, në fund të vitit 2022 prej vërejtjeve të mia që kanë qenë për mos përfundimin e disa projekteve ishte arsyetimi që buxheti është votuar me vonesë për arsye se ishte viti i parë i mandatit. Mirëpo pas disa ditësh është treguar që është shpenzuar afër 100% e buxhetit. Në vitin 2022-2023-2024

paraja publike shpenzohet 100%, ndërsa punët nuk përfundohen ashtu siç janë paraparë me ligjin e buxhetit.

Po ashtu në vitin 2024 e kam parë një njoftim që Komuna e Malishevës është e para sa i përket shpenzimit të buxhetit, mirëpo nëse e analizojmë aspektin përmbajtësor se si janë shpenzuar ato para len shumë për të dyshuar. Shumë projekte të infrastrukturës në fshatra duke përfshirë asfaltimin e rrugëve, kanalizimet, trotuarët po thuajse të gjitha fshatrat kanë qenë të parapara në buxhetin e vitit 2024, ndërsa sa i përket realizimit ato janë realizuar shumë pak, dhe ato të cilat janë realizuar janë realizuar në mënyr selektive, diskriminuese dhe duke nxitur përqamje te popullata.

Në fshatin Turjakë është shqetësuese, sepse që dy vite me radhë projektet rrugore kanë qenë të parapara në buxhetin e viteve përkatëse, është hera e dytë që kompania e cila ka qenë e kontraktuar për asfaltimin e këtyre rrugëve vetëm i fillon punimet, e bën shtrirjen e zhavorit dhe pastaj largohet pa dhënë ndonjë sqarim. Pyetjet të cilat i kanë drejtuar ekzekutivit dhe Kryetari i këshillit lokal të fshatit Turjakë- Lubizhdë dikush nga Kuvendi i ka thënë që nuk kemi para. Ju them qytetarëve që parat kanë qenë të ndara nga buxheti Komunal mirëpo arsyen e mos realizimit të tyre duhet ta jep Kryetari i Komunës.

Unë kam një vërejtje dhe me shpenzimin e grantit të performancës që Komuna e Malishevës e ka fituar për vitin 2022 mbi 600,000.00E, mua nuk më kujtohet nëse destinimi nuk është shpenzu por ka ra te shtrati i Lumit Mirusha nga ura deri te tranziti, unë nuk e di që është votuar në Kuvend. Sipas ligjit qfarëdo burim i fondeve duhet të i nënshtrohet një debati i diskutimit dhe në fund votimi nga Kuvendi Komunal. Kryetari përmes rrjetit Facebook para disa ditësh e ka njoftuar opinion, sepse ka filluar punimi i shtratit të lumit dhe pse ai shtrat ka qenë i rregulluar para disa viteve.

Raporti i auditorit është raport negativ i cili nuk e kualifikon Malishevën për të fituar grant të performancës për vitin 2023, është shqetësuese. Dua ta bëjë publike që unë si anëtarë i Kuvendit ta nxjerri konkluzionin se a ja vlenë të përkrahet ky ekzekutiv dhe kjo qeveri komunale ku çdo gjë e ka politizu. Me keq ardhje e ceki që jam shumë i zhgënjyer në këtë aspekt.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon Mazreku!

Nëse keni mundësi me ju përmbajt minutazhës sepse kemi pika të rendit të ditës ku mundeni me i përfshi disa qështje të cilat kanë të bëjnë me jashtë rendin e ditës.

Valon Mazreku (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Përsëndetje për të gjithë!

Meqenëse jemi në prag të festave të fund vitit shfrytëzoj rastin të ju uroj të gjithëve gjitha të mirat për ju dhe familjet e juaja.

Sa i përket shpenzimit të buxhetit të cilën e ngriti kolegu, paraprakisht e kemi raportin e të hyrave për 9 mujorshin të vitit 2024, ku të gjitha ato të cilat i ngriti ka mundur me i ngrit në kuadër të pikës së rendit të ditës që është e destinuar për këtë qëllim, dhe jo me dalë me bërë fushat. Duke pasur parasysh që buxheti e ka një qëllim për tu shpenzuar, dhe kur shpenzohet buxheti nënkupton që janë përfunduar disa aktivitete apo disa punë.

Komuna e Malishevës është renditur e para në shpenzimin e buxhetit për investime kapitale, kur nuk i sheh të gjitha këto projekte të cilat po bëhen dhe e sheh vetëm një rrugë që është 100m, nuk e di cila është logjika e mendimit dhe e kritikës në këtë rast.

Sa i përket grantit të performancës 2022 nuk është te shtrati i lumit, sa unë kam informat është

shtruar rruga në Turjakë me këtë grant. E ceke ligjin e financave publike është e vërtetë që të gjitha llojet e të hyrave të cilat hynë në buxhetin e Komunës duhet të aprovohen në kuvend. Granti i performancës nuk janë mjete të cilat hynë në buxhetin e Komunës. Sa i përket politizimit i nderuar mos të harrojmë që në kuadër të kësaj qeverisë janë dhe disa drejtor të cilët janë të LDK-së, ne si grup i NISMËS asnjëher as në projekte as në punësim nuk kemi thënë keni politizim dhe po kqyrni vetëm për veten. Ne jemi partneritet në qeverisje në qoftëse është bërë diçka e mirë në kuadër të kësaj qeverisje është bërë me LDK-në, në qoftë se është bërë diçka e keqe është bërë prap me LDK-në. Është mirë mos me keqpërdor foltoren.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Veton Zogaj!

Veton Zogaj (anëtarë nga VV): Përshëndetje për të gjithë!

Në emër të LVV i përshëndes të gjithë bashkëatdhetarët të cilët shumica vetëm kanë ardhur, kanë probleme me energji dhe rrugë por besoj që do të kalojnë mirë në pushime dhe i përballojnë të gjitha. Meqë është seanca e fundit për këtë vit po ndërlidhem në disa pika e para është problemi me energjin elektrike në rrugën "Hil Mosi" në Malishevë, e kemi shqyrtu në KPF një kërkesë për këtë rrugë dhe e kemi nda një shumë për me kriju qasjen apo lidhjen me rrjetin energjetik, mirëpo në kontakt me ata banorë më është thënë që nuk kanë energji elektrike që 4 vite. KEDS-i refuzon me i kyq rrjetin elektrik, sepse objekti është pa leje ndërtimore ndoshta drejtori Avdi është mirë me na sqaru se si qëndron e vërteta këtu.

Kompania hidroregjioni kam një njoftim zyrtar prej anës së tyre që Komuna ka borxhe të pa paguara ndaj Kompanis apo nuk e ka respektuar marrëveshjen për blerjen e pompave dhe ristartimin e rrjetit në vlerë afër 11,000.00E.

Qështja tjetër, përse në këtë vit nuk është bërë ndarja e bursave për student?

Një kompani e transportit publik e autobusëve është ankuar që drejtoria e shërbimeve publike i diskriminon në ndarjen e vijave, a kemi rregullore për këtë apo si i ndani këto vija. Dhe inspektorët Komunal i gjobojnë në rast se i hasin në rrugë, janë pretendime prej palës të cilat po bëhen në mënyr selektive të cilat nuk identifikohen rastet e tjera të tilla.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro Hamit Lima!

Hamit Lima (anëtarë nga LDK): Sot jemi mbledhë për mbledhjen e fundit për këtë vit. Një vit jo i mirë për qytetarët e Komunës tonë. Ka shumë pika të rendit të ditës por që nuk dua të merrem me ato sepse janë shumë të këqia. Siç është kërkesa e 29 shtatorit me shiku me dhënë në mes të Malishevës pronë në kompenzim është shumë e ulët shumë keq, dhe shumë e dëmshme për Malishevën.

Qështja për energji elektrike Kryetari nuk qenka këtu, sepse e kish përcjell mirë postimin tim, është mirë me u marrë Kryetari i Komunës sepse është i zoti i shtëpis. Është Muharremi zyrtar ligjor dhe e dinë a ka të drejtë Kryetari me padit KEDS-in, ja lejon me ligj për dëmet të cilat ju ka shkaktuar bizneseve, për dëmet të cilat ju ka bërë qytetarëve tonë.

Sa vendimi është marrë këtu dhe nuk janë zbatuar, po e cekim vendimin për shisha bar ato janë duke u përdor sikur mos me u marrë asnjë vendim. A është problemi Kryetari që ka lëshuar penjë apo Drejtori i Inspektoriatit nuk ka forcë me i ndalë. Qfarë është problemi këtu?

Vendimi për parcela për mbeturina inerte përse nuk zbatohet, dhe me u rregullu parcelat për mbeturina inerte, pjesë e komisionit jemi une dhe ti. Ti je Kryesusi i Komisionit duhet me na thirr.

Vendimet të cilat janë marrë për anëtarë të Komisioneve jo obligative, secilën ditë borgji është duke ju rrit Komunës, sepse nuk është duke e bërë asnjë pagesë për anëtarë të këtyre komisioneve.

E kemi parë në postime në Malisheva Sot kur Kryetari i nëndegës së Nismës në Banjë, dhe Kryetar i këshillit të bashkësis lokale të bordit ai në vend që të punojë mirë për qytetarët, për biznese ai e bënë një shënim shantazhon që e ka ozupu pronën publike. Unë kam një marrëveshje me këshillin e gjamis në Banjë që nga 01.01.2022 paguaj qera kur do që e shohin të arsyeshme mundem me liru pronën.

Nuk qenka nënkryetari këtu ai po mban takime në lagje të Banjës, ai letë mbanë takime por emrin kur nuk jam aty mos leta përmend. Në vitin 2021 ka thënë lehtë tërhiqet nga gara Hamiti dhe do i japim 4 vite rrogë, kërkoj nga nënkryetari që mos të më mbaj vesvesen mua. Unë kam qenë dhe do të jemi gjithmon në LDK.

Për arsye të gjitha këtyre gjërave të cilat i ceka dhe pakënaqësis unë lëshoj sallën nuk do të marrë pjesë në seancë.

Hamit Lima dhe Driton Kastrati lëshojnë sallën.

Kryesus i Kuvendi- Argjend Thaçi: Urdhëro, Halil Morina!

Halil Morina (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Dhe unë si parafolësit ju dëshiroj bashkë atëdhetarëve tanë qëndrim të mirë në vendlindjen e tyre.

Demokracia i ka disa mangësi të veta, por ne jemi të detyruar ti vuajm dhe këto pasoja që ti prodhon demokracia.

Unë dëshirova ta ngris një qështje që ka të bëjë me energjinë elektrike, përpjekjen e shumë njerëzve dhe disa prej kolegëve tanë këtu që janë mundu me kthi këtë punë për qëllime të politikës. Nuk jemi duke vuajtur vetëm ne, është duke vuajtur e gjithë Kosova. Çdo ditë shoh postime të kolegëve të komunave të tjera për munges të rrymës, kjo është paafësi e qeveris së Kosovës me siguru rrymë. Të gjithë e dimë vendi i jonë prodhon 600më orë rrymë ndërsa nevoja për rrymë është mbi 1200-1500më në orë. Nuk është problemi te Kryetari i Komunës sepse ne nuk prodhojmë rrymë, është gjendje e krijuar jo si pasojë e jona por si pasojë e pa aftësis së qeverisë. Të gjithë jemi dëshmitar për keqpërdorime me rrymë, qindra miliona euro janë vjedhur te qështja e rrymës dhe kjo është pasojë që nuk kemi ne rrymë. Parafolësi i cili ke këtu nuk janë gjëra të cilat fliten në kuvend, që tri vite kur ke pas interes personal tu ka realizu dhe në momentin kur nuk tu ka realizu vjen e banalizon këtu, nuk është e ndershme. Në qeverisje mund të ketë dhe mangësi por jo meritat me i marrë për veti dhe ndonjë gjë që nuk ka ndodhë siç duhet me ja lënë fajin tjetrit. Kisha kërkuar mos të i përziej qështjet nacionale me politikat tona dhe debatet të cilat zhvillohen mbrenda Komunës së Malishevës.

Kryesus i Kuvendit- Argjend Thaçi: Veton nuk mundesh me marrë fjalën pa ta dhënë unë. Nuk ta shenojm në procesvërbal.

Veton Zogaj (anëtar nga VV): Unë po flas ju mos e shenoni në procesvërbal, sepse shumë akuza janë thënë më duhet ta bëjë repliken time. E para Halil po na lun këtu të moralshmin po dua me ta thënë qart dhe për herë të fundit replikoj për këtë qështje. Kur ka protestuar VV-ja për shitjen për 26,000.000.00E të KEDS-it që e ka bërë bashkë partiaku yt Kryetari i partis tënde së

bashku me dostat e vetë, janë arrestu aktivistat e VV-së ju keni hesht. Kur është puna me marrë meritat të parët vendosni në postim, Kryetari me Drejtorin i cili iki tani me 19 tetor del në kodrat e Rahovecit thot një vit me rrymë, e zgjidhëm problemin e rrymës, kur është me bërë kritikë fshehen. Përgjegjës për këtë është Kryetari i cili e ka zvarritë sa e sa për me dhënë një hapsir publike për me ndërtu trafo-stacionin. Një mandat ju ka shkuar nuk keni mundur me zgjidhë një qështje duke u shtyrë ja këtu nuk po më konvenon. Sot ish stacioni në përfundim, me pas fillu në shtatorin e kaluar, kështu që kur të flasësh duhet me argumente jo vetëm me bërë fushatë.

Kryesus i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Halil Morina!

Halil Morina (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Mu asnjë të vërtet nuk mundesh mema plas fytyrës, sa i përket qështjes së të moralshmit, në raport me ty e luj jo të moralshmin por e luj edhe engjullin. Qe 10 vite letë ma gjenë dikush një përdorim të politikës për nevoja personale, asnjëher nuk kam bërë marrveshje politike, nuk kam bërë pazar me i thënë me ma shti një familjar në punë. Ti ke bërë marrveshje me shti gruan tënde në gjimnaz në punë, sa ka qëndruar grua jote në punë ti nuk ke bërë zë, në momentin kur e ka gjetë gruaja jote një punë ke filluar të flasësh. Prej që ke qenë kolegë me mua ti ke qenë injorant dhe gjithë karriera jote politike është injorant sepse pozicionin që e ki këtu, e ke marrë si bartës i listës. Ti e ke shit të moralshmin në politik dhe ti ke hyrë në mënyr të paligjshme në vendin e punës, rrogën të cilën e merr këtu ta ka falë partia. Rrogën të cilën e merr atje ta ka falë partia, sepse nuk je i zoti me jetu duhet me të mbajt dikush. Ti ke bërë marrëveshje me këta të partis time, unë kurr nuk kam bërë marrëveshje.

Kryesus i Kuvendit- Argjend Thaçi: Të nderuar anëtarë të Kuvendit kërkoj qetësi, dhe mirëkuptim mos ta degradojmë gjuhën e kuvendit ashtu siç ka qenë deri më tani. Nuk kemi nevojë me bërë polemika dhe debate të tilla jashtë gjuhës parlamentare. Urdhëro, Alban Kastrati!

Alban Kastrati (anëtar nga PDK): Unë nuk po ndihem mirë për gjendjen që po shkaktohet këtu, këto janë efektet e fushatës të cila kanë filluar para kohe dhe nuk është pasqyr e mirë për qytetarët e Komunës së Malishevës, sepse ata na kanë zgjedhur me i diskutu gjërat, por jo në këtë formë siç e pamë. Kërkoj nga ju kolegë të përmbaheni jo të përdorni fjalë fyese sepse është tejkalim i gjuhës parlamentare.

Sot është seanca e fundit dhe shfrytëzoj rasti të ju urojë festat e fund vitit gjithë qytetarëve të Malishevës dhe ndërkoh ju kërkoj falje qytetarëve dhe mërgimtarëve që po kalojnë këto ditë të vështira në munges të rrymës energjetike, pastaj dhe me kaosin e rrugëve që janë në Malishevë. E pash grupin parlamentar të LDK-së se si e shprehin mllëfin e tyre tani mbas 3 vite qeverisje, kur ne jemi dëshmitar që asnjë seanc nuk e kemi filluar me kohë duke i pritur pazaret e tyre kur i bëjshin në salla jashtë asambles. Po ju drejtona qytetarëve, u pa fytyra e vërtet e këti kualicioni 3 vjeçarë. I cili ka qenë kualicioni i mashtrimit të qytetarëve, i favorizimit dhe mbrojtjes së interesave personale këta nuk kanë të bëjnë asgjë me interes të përgjithshëm të qytetarëve. Kjo është vërtet për keqardhje, sa i përket qeverisjes Komunale për këto 3 vite unë kam parë vetëm zhgënjime. Keni filluar ti diskriminonin dhe vlerat e luftës dëshmorët, familjet e dëshmorëve po i injoroni si te punësimi si te infrastruktura rrugore.

Për shkolla nuk po flasim shumica e mësimitdhënësve nuk kanë normë të plotë vetëm për me i kthy me votu partin e juaj.

Kryesues i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Labinot Gashi!

Labinot Gashi (anëtar nga LDK): Meqenëse është mbledhja e fundit për këtë vit po ashtu dhe unë ju uroj mirëseardhje në familjen dhe vendlindjen e tyre të gjithë mërgimtarëve, inshallah kalojnë si është më së miri dhe pse jemi në kushte të vështira.

Qështja e energjis elektrike, kemi votuar një sipërfaqe shumë të madhe me ju dhënë KEDS-it për investime kapitale. Pyetja lind si dhuron Kryetari tokë pa e pasur KEDS-i një plan investim? Në çdo fshat kemi problem. A ka mundur KEDS-i të paktën këta tela të cilët janë të vazhduar dy tre herë prej shtyllës në shtyllë me i ndërru, me i vendos kabllo të paktën kur ka reshje dhe frymë mos me pas ndërprerje të rrymës.

Replikat të cilat ndodhën në mes kolegëve të partis time, unë jam në LDK është mandati i 3 por kurr votë me kusht nuk kam dhënë. E dini qasjen e koalicionit si ka ndodhë, te qështja e buxhetit kur ne përjashtohemi si të zgjedhurit e qytetarëve te miratimi i buxhetit nuk e di si pranojnë me ulë dinjitet-in e kuvendit me repliku për gjëra personale, që aspak nuk i pëlqej dhe nuk e përkrahi asnjërin prej parafolësve me fol për gjëra personale në kuvend kur ne jemi të thirrur për diqka tjetër. Buxheti i fundit për vitin 2025 është thirrë me 28 shtator, a votuar buxheti në ditën e shtunë ditë pushimi është skandal nuk ka pasur asnjë urgjenc. Përse është bërë, sepse është arroganca e numrave. Unë këtë fund e kam parapa, mundohna çdo her me qenë parimor jo me diskutu për gjëra personale. Unë kam qenë udhëheqës i rregullores për bashkësi lokale, është përgjegjësi e Kryesusit të Kuvendit me dalë me bërë debate me i marrë prej bashksive lokale, nuk ka ndodhë në asnjërin.

Ka shumë probleme në arsim është mandati i 3 i Nismës, është qështja e Drejtorëve ka shkollë që nuk ka drejtor qe 7 vite, ki orë të pambuluara sepse duhet me ja ru vendin deri të shkon Xpersoni në pension.

Probleme në shëndetësi, punësimet në shëndetësi ndodhin me listë, një person është doktor nuk e marrin atë, por i marrin familjar të tyre. Kjo është gjendja e qeverisjes në Malishevë.

Përse e ka Malisheva 98% të buxhetit të shpenzuar sepse e ka një projekt të vetëm, buxheti nuk është vonuar, buxheti është kthyer shkak i ankesës që e kemi bërë ne. Është marrë mandati me 57.6% investime kapitale të bartura nga mandati i kaluar, ndërsa buxheti i vitit 2025 që ju kolegë e keni miratuar pa e shiku 70% është buxhet i bartur, kur doni shikone analizoni qka keni votuar.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Arlind Morina!

Arlind Morina (anëtar nga LDK): Dhe unë ju dëshiroj të gjithë mërgimtarëve të Komunës së Malishevës mirëseardhje në vendlindje dhe pushime të rehatshme.

Kërkoj nga kolegët, është fundi i vitit ne duhet ta përfundojmë këtë seanc në mënyr solemne dhe ta përfundojmë këtë vitë siç duhet, koha për bërëryla është mbas 9 Janarit deri me 9 Shkurt secili nga ju e keni mundësin me tregu forcën e juaj politike. Është mirë me tregu kulturën e juaj, të gjithë ne jemi në lëkurën e qytetarëve të Komuës së Malishevës sepse e kemi përjetu dhe vetë ne, kam qenë kritiku më i madhi për gjendjen e rrymës elektrike. Gjendja e rrymës në Komunën e Malishevës të gjithë e dimë që është katastrofike, tani nuk duhet të dalim me thënë e bëri ai e bëri ky dhe me kalu situata deri në familje.

Kualicionet kanë ndodhë mund të prishet të rregullohet, demokraci është kush dëshiron me qëndru qëndron, kush nuk dëshiron mund të largohet. Nuk e di përse po e debatojm këtë gjë,

kërkoj nga ju të largohet gjuha e urrejtjes të kërkohej falje miqësore, sepse i kemi kaluar 3 vite pa asnjë akses dhe mos të shkojmë në ofendime. Kërkoj nga ju nga bashkëvendasi Halil pastaj nga Vetoni sepse është mirë ta mbyllim një vit mirë.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Faleminderit Arlind për gjuhën e unifikimit dhe bashkëpunimit. Urdhëro, Agnesë Kastrati!

Agnesë Kastrati (anëtare nga VV): Kryesus unë mendoj që e gjithë këtë situatë ti e cyle në këtë pike, sepse rezistenca jote për me ja dhënë fjalën Vetonit për një replik që i takon, dhe lehtësia që ja jep fjalën Halilit për kundër replik len shumë për me dëshirë. Ju gjithë e keni kryesë kuvendin me shaka por kësaj radhe për mendimin tim ke mos kryerja e detyrës tënde si Kryesus për me mbajtë rendin. Ne e kuptojmë që jemi në një fushatë jemi të vetëdijshëm për sikletin të cilin e kanë subjektet politike, por është e rëndësishme që këtu të vijmë për rendin e ditës të cilin e kemi. Kush do që dëshiron me u marrë me politika më të larta të kuvendit apo të qeverisë është mirë me kandidu kush do që ka ambicie. Është e pa dëshirueshme me dëgju nga Nisma prej kësaj qeverie e cila së paku dy vite ne vimë dhe i shofim karriket e zbrazëta dhe nuk tregojnë minimumin e respektit ndaj nesh, dhe ndaj pyetjeve të cilat janë nga qytetarët e Komunës së Malishevës. Me fol këtu për punësime për njerëz të cilët ne i njohim dhe i dimë është totalisht e pa pranume me gjithë atë unë vazhdoj me qenë shumë e qetë sepse pragu do të jetë shumë i lartë.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Unë Kuvendin nuk e kam udhëhequr me shaka. Urdhëro, Burim Paqarizi!

Burim Paqarizi (anëtar nga PDK): Unë dua të ju uroj qytetarëve festat e fund vitit, mërgimtarëve gjithashtu pushim të këndshëm. Unë dua të i ngris disa qështje e para problemi me energjin elektrike u dhanë disa arsye por duhet të bëhet presion dhe punë më e madhe që ky problem të zgjidhet pasi që të gjithë ne kemi probleme të vazhdueshme me këtë gjë. Problemi tjetër me infrastruktur, ne e përmendëm që thuajse i tërë buxheti ka shkuar në një projekt duke lënë shumë mangësi në projekte të tjera. Unë kam pasur fatin e keqë para dy jave kanë shpërthyer dy gomat e veturës time për arsye se gjendja e infrastrukturës është e mjerueshme, nuk e kam vetëm unë këtë problem por e kanë të gjithë.

Drejtori i urbanizmit paska shkuar sepse dëshirova me i dhënë disa vërejtje, ne e kemi kontratën për mirmbajtjen e rrugëve është mirë që në këtë kohë me i sanu disa gropë, sepse është fluski shumë i madh i qytetarëve në këto ditë e mërgatës.

Një qështje tjetër me rëndësi është qështja e arsimit, shumica e shkollave nuk kishin sasi të mjaftueshme të energjis djegëse kanë mungesë të mëdha, disa shkolla janë duke i mbajtur orët me orar të shkurtuar, shpresojmë që në gjysëm vjetorin tjetër kjo punë të përfundohet sa më shpejtë që mos të kemi probleme.

Kryesusi i Kuvendit-Argjend Thaçi: Urdhëro, Mirëllinda Gashi!

Mirëllinda Gashi (anëtare nga PDK): Dhe unë si kolegët i urojë gjithë mërgatës pushime të mira në Kosovë. Dua të di nga ju a keni bërë ndonjë kërkesë për rrugën regjionale Kijevë-Malishevë që sa vite nuk investon askush në atë rrugë është në gjendje katastrof. Tjetra është rruga tranzit që lidh shtëpinë e shëndetit dhe shkollën janë duke u bërë shumë ndërtime në atë

pjesë dhe trotuari në të dya anët është i shkatërruar. Kisha kërkuar nga qeveria nga inspektoriati dhe nga Policia që atë pjesë ose të bëhet vetëm për këmbësorët kërkoj nga Policia të dalë dhe të vendos shirita dhe pjesë mbrojtëse që me pas fëmijët kujdes.

Te pjesa e energjis elektrike, e gjithë Kosova është e pa kënaqur, në të gjithë Kosovën ka reduktime. Dua të ju bëjë një pyetje qfarë kemi bërë ne si asambleist kur është organizuar protesta, asnjë nuk kemi dalë në protest. Asnjë nuk kemi shkuar me bisedu me Kryetarin me ja bërë ndonjë pyetje, a kemi bërë ndonjë grup punues si asambleist me shku te dyert e KEDS-it me bisedu. Ja ku e kemi Vetonin hapna rrugen Veton ta takojmë dikënd të ministrit letë na informon qka ka bërë Kryetari, qfarë kërkesa ka bërë. Asnjëri asgjë nuk kemi bërë dhe vimë këtu mburremi. Nuk e kam prit as prej Vetonit as nga Halili gjuhën të cilën e përdorën. Pres nga kolegët e mi të bëjnë kërkim falje ta mbyllim këtë vitë si duhet. Leta fiton më i mirë por leta ka gjithmonë parasysh qytetarin e republikës së Kosovës. Njëherë ka thënë Hashim Thaqi Kosovën nuk e dua pa rrymë, unë e dua rrymën dhe nuk ka pasur asnjë ditë ndërprerje të rrymës. E gjithë Kosova ka probleme me reduktime, këtë vitë është më stabile jo si viteve të tjera përse nuk po e cekni këtë. Ju kisha lut të qetësoheni na pret një rend i ditës shumë i gjatë.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Të nderuar anëtarë të kuvendit në mbështetje të dy kërkesave të Arlindit, Mirë lindes po ashtu dhe timen si Kryesus kërkoj reflektim nga Halili dhe Vetoni për situatën e krijuar më parë.

Urdhëro, Halil Morina!

Halil Morina (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Unë po i bëjë 3 vite këtu dhe të gjithë jeni dëshmitar që në secilin fjalim timin kam qenë i kujdesëshëm mos me përdor asnjë fjalë fyese, dhe mos me prek askënd personalisht. Sot fjalimi im nuk ishte personal për askënd, deklarimi im në foltore ishte për shqetësimet për qështje të përgjithshme ngrita akuza sipas opinionit tim ku është faji për gjendjen e rrymës dhe doli kolegu në replikë nuk e pengova e dëgjova, unë e konsideroj veten që nuk isha shkaktar i gjithë kësaj. Prap se prap unë i kërkoj falje secilit anëtar të kuvendit përveq inicuesit të kësaj situatë. Mirëpo letë shohin të gjithë kush ishte iniciuesi i gjithë kësaj situatë, kush ndërhyri në fjalimin tim dhe kush më nxiti me ju rikthyer në atë mënyrë. Nuk e kuptova pse këtë reagim dhe përse kthimin prej një qështje publike në qështje personale. Por për mua nuk është dhe shumë e quditshme sidomos për njerëzit që i njoh.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Veton Zogaj!

Veton Zogaj (anëtar nga VV): Kush më njeh mirë dhe kush e ka përcjell Vetonin prej ditës së parë asnjëherë nuk kam shkuar në akuza personale, kritika ime ka qenë drejtuar vetëm mbi bazën e argumenteve dhe mbi bazën politike. E mira e kësaj pune është sepse ka inqizim këtu mund ta shohim të gjithë së bashku kush e ka inicuar këtë dhe kush ka shkuar me akuza personale. Të gjitha i kam ditë kush ku punon por kurrë nuk jam shprehur në atë mënyrë, por kur del këtu dhe thotë akuza të pa vërteta dhe në familje të prek, e ka përdorur dhe mos prezencën time. Unë ju kërkoj falje kolegëve dhe qytetarëve. Dua të sqaroj për opinionin publik sepse u thanë shumë të pavërteta këtu, e para Gruja ime ajo nuk punon në institucione publike punon në organizatën Sosfshatrat e fëmijëve, vetëm një muaj ka punuar në gjimnazin "Hamdi Berisha" në Malishevë. Unë kur jam punësuar në këtë vend të punës që aktualisht e kam është sqaruar ky rast prej A deri në Zh nga mediat deri te prokuroria dhe nuk kanë mundur me gjetë asnjë gjë. E ftojë Halilin të vijë

me mua në ndërmarrje ta dhe të gjithë dosjen time dhe arsyetimin e prokuroris dhe nëse gjen diqka unë publikisht largona.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Veton dhe Halil faleminderit për konsideraten dhe kërkim faljen tuaj.

Valon Mazreku (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Kisha kërkuar ta miratojmë rendin e ditës.

Kryesusi i Kuvendit-Argjend Thaçi: A ka dikush diskutim për rend të ditës? Urdhëro, Veton Zogaj!

Veton Zogaj (anëtar nga VV): Në emër të grupit VV kërkoj që pika e 4 të rendit të ditës me u largu nga rendi i ditës. Nëse kjo pikë kalon ne marrim pjesë në pikat e tjera të rendit të ditës, e dhëjmë qëndrimin tonë politik dhe nuk marrim pjesë në votim e lëshojmë sallën për këtë pikë.

Kryesusi i Kuvendit-Argjend Thaçi: Urdhëro, Halil Morina!

Halil Morina (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Pasi rendi i ditës është kaq shumë i ngarkuar dhe na shkoj gjysma e ditës kisha kërkuar që pika e 3 që është shqyrtimi i auditimit me u largu nga rendi i ditës pasi ka kaluar shumë kohë. Një kërkes tjetër që nuk po e shoh në lidhje me këshillin për siguri në bashkësi në lidhje me pagesat, konsideroj që ajo qështje duhet me u trajtu me të gjithë komitetet dhe komisionet e tjera dhe jo me u trajtu si e veçant kështu që kisha kërkuar që dhe kjo pikë me u largu dhe nga Janari i vitit 2025 me zgjidhë qështjen e këtyre komisioneve.

Kryesusi i Kuvendit-Argjend Thaçi: Urdhëro, Veton Zogaj!

Veton Zogaj (anëtar nga VV): Raporti i Auditimit është obligim ligjor që duhet me u diskutu, ndërsa për pikën të cilën e cekim pika 9 mund ta lërojmë.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Alban Kastrati!

Alban Kastrati (anëtar nga PDK): Pika e 4 që e cekim Vetoni jo me u shty por me u largu si pikë e rendit të ditës dhe insistojmë që një veprim i tillë të mos ndërmirret nga organet Komunale që mos të rrënohet objekti në fjalë sepse është një vlerë dhe një investim shumë i madh, dhe nuk e di si mundet me u marrë një vendim me u rrënu një objekt që mban emrin e dëshmorit dhe të zëvendësohet me një autoparking. Kishte qenë mirë me u diskutu me qytetarët dhe jamë shumë i sigurt që dhe qytetarët nuk do pranonin që me u rrënu ai objekt, sepse është një vlerë dhe mban emrin e dëshmorit “Jahir Krasniqi”. Ne si grup i PDK-së e mbrojmë fuqishëm këtë qëndrim tonin dhe sigurisht do të përdorim të gjitha instancat që mos të lejojmë të bëhet rrënimi i tij.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Labinot Gashi!

Labinot Gashi (anëtar nga LDK): Shumica e pikave të rendit të ditës për arsye të mos mbajtjes së mbledhjeve kanë humbur relevancën kohore pajtohem që raporti i auditimit është dashur të vijë më herët por është obligim ligjor të debatohet.

Raporti i të hyrave gjithashtu gjashtë mujorin e kemi kaluar, nuk ka asnjë logjikë që raporti i gjashtë mujorshit me ardhë në fund të vitit.

Te pika e 9 pajtohem nuk ka nevojë Komisioni i KKSB-së me sjellë pikë të veçant sepse ne këtë problem e kemi trajtu gjatë tërë vitit, sa dëgjova unë e kanë ofru një zgjidhje ju kanë rrit shujtat po i paguajn Komisionet me 30% të pagës së asambleistit. Këtu është një keqinterpretim i udhëzimit dhe ligjit të pagave. Unë jam anëtarë i asambles nuk marrë pagë nga kjo punë, sepse e kam punë sekondare, kam ardhë me vullnet. Jam pjesë e komisionit dhe dua të më paguhet mëditja, ne qdo mbledhje po kemi formimi i komisionit për dhënie të pronës, e si me dhënë pronën pa komision. Nëse ma kërkon si ndihm me punu vullnetarisht jamë i gatshëm të punoj jo vetëm unë por besoj të gjithë ne. Prandaj propozoj që kjo pikë të largohet. Qështja e listës së pronave Drejtori nuk është këtu qka kemi me debatë këtu, unë dua sqarime për disa prona nuk ka asnjë specifikë kisha kërkuar të kargohet kjo pikë. Procecvërbalet, nuk ka pasur asnjë urgjencë me ardhë procesverbali i muajit shkurt në muajin dhjetor me qfarë logjike.

Kryesusi i kuvendit- Argjend Thaçi:Urdhëro, Halil Morina!

Halil Morina (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Unë i kisha dy propozime për largime të pikës së 3 dhe pikës së 9, por meqë pika e 3 po konsiderohet që është obligimi ligjor kërkoj që vetëm pika e 9 të largohet nga rendi i ditës.

Kryesusi i kuvendit- Argjend Thaçi: Nëse nuk ka askush tjetër për diskutim e hedhi në votim kërkesën e Vetonit që pika e 4. Kërkesa nr. 01/429 datë: 29.10.2024 për dhënie në shfrytëzim afatëgjatë të pronës publike, konform vendimit të Kuvendit nr. 02/121 datë: 08.03.2024. Kush është që kjo pikë të largohet nga rendi i ditës.

Për: 10

Kundër:13

Abstenim: 2

Me 10 vota Për, 13-Kundër, 2-Abstenime mbetet si pikë e rendit të ditës.

Propozimi i Halilit që pika e 9. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/973 datë: 28.08.2024, për kompenzim për anëtarët e KKSB-s për takimet e rregullta të mbajtura gjatë vitit 2023 dhe 2024 të largohet nga rendit i ditës. Kush është për?

Me vota unanime pika e 9 largohet nga rendi i ditës.

Propozimi i Labinot Gashi ishte që pika e 5. Shqyrtimi dhe miratimi i listës së pronave të paluajtshme të Komunës të largohet nga rendi i ditës.

E ceka që kjo është obligim ligjor që deri me 31 dhejtor të miratohet. E hedhi në votim kush është për që të largohet kjo pikë?

Për: 10

Kundër: 15

Abstenim: 0

Pika e 5 mbetet si pikë e rendit të ditës.

E hedhi në tërsi rendin e ditës me plotësim ndryshimet e bëra, kush është për këtë rend të ditës?

Për: 15

Kundër: 10

Abstenim: 0

Miratohet ky rend i ditës.

Vazhdojmë me pauz rikthehemi prap mbas pauzës.

Vazhdojë me pjesën e dytë me punimet pas miratimit të rendit të ditës fillojmë me pikën e parë që është:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së dytë të rregullt e mbajtur me datë: 29.02.2024, procesverbalit të mbledhjes së tretë të rregullt e mbajtur me datë: 12.03.2024, procesverbalit të katërt e mbajtur me datë: 30.05.2024, procesverbalit të pestë të mbajtur me datë: 13.06.2024, procesverbalit të gjashtë të rregullt e mbajtur me datë: 03.09.2024, procesverbalit të mbledhjes së parë të jashtëzakonshme e mbajtur me datë: 28.06.2024, mbledhjes së dytë të jashtëzakonshme e mbajtur me datë: 29.07.2024, mbledhjes së parë urgjente e mbajtur me datë: 28.06.2024 dhe mbledhjes së dytë urgjente e mbajtur me datë: 28.09.2024. Urdhëro, Valon Mazreku!

Valon Mazreku(anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Po e votojmë në tërësi është procedur me votu.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Nëse nuk ka askush për diskutim e hedhi në votim pikën e parë. Kush është për?

Për: 18

Kundër: 0

Abstenim: 4

Me 18 vota Për, 0- Kundër, 4- Abstenime miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Vazhdojmë me pikën e 2. Shqyrtimi i raportit të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën Janar-Shtator 2024. Prezent e kemi Drejtorin për Bugjet dhe financa Z.Blerim Thaçi i cili në pika të shkurtëra do të na prezantoj.

Drejtori për Bugjet dhe Financa-Blerim Thaçi: Dhe unë shfrytëzoj rastin me ju uru festat e fund vitit të gjithëve. Është e vërtet që jemi vonuar për prezantimin e raportit 9 muhor, unë do të flas në pika të shkurtëra, një kohësisht do ta jap dhe një pjesë të raportit për periudhën Janar-Nëntor. Ju e dini që në fillim kur është votuar buxheti për vitin 2024 ka kapur shumë prej 19,740,806.00E, duke ju bashkuar dhe në SIMFK si buxhet përfundimtar kap shumë prej 20,816.046.24E, shuma e tejkallimit pjesës së të hyrave në këtë periudhë ka qenë 556,245.74E. Bugjeti i alokuar për periudhën (Janar- Shtator 2024) kap shumë prej: 18,766,465.41E çka do të thot se shkalla e realizimit të alokimit të buxhetit në këtë periudhë është 94.79%. Ndërsa shkalla e shpenzimit të buxhetit në këtë periudhë (Janar- Shtator 2024) kap shumë prej 94.79%. Si total kap përqindjen 90.15%. Sipas buxhetit për vitin fiskal 2024 nga të hyrat vetanake janë planifikuar të mbledhen, 916,849.00E dhe tejkallimi për këtë periudhë është 522,491.00E që si shumë totale e arrin vlerën 1,473,094.74E. Në periudhën 1 Janar- 1 Dhjetor total i të hyrave nga të gjitha të hyrat vetanake nga gjobat është 1,480,713.59E që do të thotë realizimi i të hyrave në total e arrin përqindjen në 262% që do të thotë është më shumë 162% mbi bazën e alokimit të realizimit të të

hyrave. Përqindja e buxhetit të shpenzuar për këtë periudhë e kap vlerën 95.23% është fjala për buxhetin total ndërsa te kapitale është 96.8%.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: E hapi diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës.
Urdhëro, Valjeta Hoti!

Valjeta Hoti (anëtare nga PDK): Unë deshta të ndalem te shpenzimet për mallra dhe shërbime në mënyr analitike Janar- Qershor 2024 nuk e di a e keni bërë me qëllim apo e keni harru që shpenzimet për vitin 2024 nuk i keni vendos vlerat vetëm është një vlerë totale. Është e pamundur me bërë një krahasim të duhur dhe te tabela 7.5 nuk jam kundër investimeve por ne jemi mësuar kur bëhen investime me pa dhe foto kështu që u habita pak. Përshembull e kemi investimin e rrugëve në vlerë prej 4,327,440.02E, trotuare, rrethoja nëse ka mundësi një shpjegim më të gjerë se qfarë është kjo. Kemi dhe hapsirat publike që është një vlerë shumë e madhe, paisje bujqësore dhe pastaj kemi Vendime gjyqësore që është një vlerë shumë e madhe.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Veton Zogaj!

Veton Zogaj (anëtar nga VV): Po ndalna te të hyrat vetanake dukshëm ka përmisim në raport me vitin paraprak meqenëse në disa kategori shihet rënje të hyrave vetanake. Përshembull taksa tjera administrative është 18,345.89 në këtë vit ndërsa ka qenë 29,432.53E në vitin 2023. Taksa për mjete motorike këtu kemi 10% rritje. Taksa komunale për ushtrim të veprimtaris për qfarë veprimtari bëhet fjalë këtu, kemi 10,000.00E më pak. Taksa për ndërrim pronari të tokës pra i kemi 1,000.00E më pak. Gjjobat nga inspektoriati i kemi 555.00 ndërsa në vitin 2023 i kemi 7,041.20E. Largimi dhe deponimi i automjeteve këtu i kemi 1,000E më pak. Taksat për legalizim e kemi 0 inkasim për këtë kategori. Dhe gjjobat nga gjykata 29,375.96E ndërsa në vitin e kaluar ka qenë 34,613.33E.

Shqetësus për mua mbetet fakti që kemi paguar 1,200,000.00E përmbaues për arsye të vendimeve fiskale kjo është pasqyre e keqmenagjimit të qeverisjes.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: A ka për diskutim?
Nëse jo ftoj Drejtorin që të ju përgjigjet pyetjeve të cilat u bënë.

Drejtori për Buxhet dhe Financa-Blerim Thaçi: Po filloj nga Vetoni është fakt që përmbauesit të qështja e shujtave të mësimdhënësve për këtë vit rreth 1,2 milion, arsyet i dini nuk mund të japim shpjegim. Është një gjë të cilën nuk mundemi me ndalë kemi pasur takime me nivelin qëndror por nuk ka pasur ndonjë lëvizje. Ka qenë për të mirën e mësimdhënësve që janë kompenzu pagat.

Taksat e tjera administrative janë taksa të cilat i marrim nga shërbimet, sa shërbime kryhen inkasojmë mjete.

Taksat për mjete motorike edhe kjo është qështje e cila vjen nga regjistrimi i automjeteve. Taksa për ushtrim të veprimtaris është qështja te veprimtaris së bizneseve kaq kanë paguar. Taksa për ndërrim të pronës edhe kjo është një qështje që ne nuk mund ta rrisim nivelin e inkasimit.

Gjjobat nga inspektoriati pjesa e vitit 2023 është një ulje vërtet e inkasimit mirëpo janë në procedur për vitin 2023 e cila është 7,041.20E. ka pasur lënd që kanë shkuar në gjykat dhe me përmbaues por presim dhe për vitin 2024-2025 të rritet inkasimi nga gjjobat e inspektoriatit.

Licenca për afarizëm nuk e di se sa licenca janë lëshuar por mbi bazën e paisjeve me licenca janë inkasu dhe këto mjete.

Taksa për legalizim në këtë vit nuk kemi, duhet të pytet drejtorja e urbanizmit a ka pasur legalizim të objekteve që të kemi të hyra nga kjo pjesë. taksat nga gjykatat është një ulje do kishte qenë fat mos të kishim pasur asnjë të hyr nga denimet nga gjykata por kjo është pjesë e të hyrave që janë krijuar nga gjykata.

Valjetë pajtohem me ty kjo rubrika mungon por do të ishte problem i vogël me i grumbullu këto shtylla lartë sepse është formula por pajtohem me ju që është dashur me qenë kjo rubrik.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Labinot Gashi!

Labinot Gashi (anëtar nga LDK): Meqenëse Drejtori Avdi Morina qenka këtu te tabela 8.3 vazhdimisht është duke u bërë e njëjta gjë 54494 ndërtimi i trotuarëve në Kijevë. Bubavec dhe Stapanic vlera 105,000.00E. Ka dhe projekte të tjera të cilat janë të bartura nuk e di që është punuar ndonjë trotuar aty.

Mirëmbajtja e ujësjesit Kijevë-Bubavec vazhdimisht 150,000.00E, unë nuk e di të paktën po kërkoj sqarim. E ceke që është performanc e mirë grumbullimi i të hyrave vetanake 162% është ngrit. Nga konkretisht është ardhë kjo rritje e të hyrave, kisha kërkuar sqarim.

Buxheti i Kuvendit të hyrat e planifikuar i ka pasur 350,000.00E vetëm 52% janë shpenzuar parat e kuvendit, kuvendi e ka buxhetin e vetë dhe ende jemi me karrike të dëmtuara.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Drejtor Blerim Thaçi!

Drejtori për Bugjet dhe Financa-Blerim Thaçi: Unë kam mundur me sjellë listën e shpenzimit nga lëndët përmbartimore aty i kemi pasur ekzekutiv mjetet nga të gjitha kategorit. Qështja e rritjes së të hyrave janë tre faktor njëri prej tyre është niveli i pagesave të tatimit në pronë, në këtë vit jemi në tejkalim me vitin e kaluar mbi 150,000.00E që kemi më shumë të hyra. Pastaj kemi nga urbanizmi pjesa e lejeve të ndërtimit dhe lejeve mjedisore. Këtë pjesë duhet ta kemi parasysh që kjo nuk është e hyrë vetanake dhe donacioni që e kap vlerën 326,000.00E është shtesë për Komunën që e kemi fituar mbi bazën e performancës.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon Mazreku!

Valon Mazreku (anëtar nga Nismasocialdemokrate): Qytetarët e Komunës së Malishevës janë vetëdijesë për shlyerjen e obligimeve të cilat rrjedhin nga tatimi në pronë dhe nga taksat e tjera të cilat janë obligative. Sa i përket nga tabela e investimeve kapitale e ceki dhe Drejtori, Labinot mjetete të cilat shfrytëzohen nga një kod dhe në qoftëse janë shfrytëzuar prej thesarit qëndror ato e kanë burimin, dhe burimi është ai kod. 50,000.00E të cilat i ceki Burimi janë dy apo tri vite ka hyrë për Komunën shërbimet rezidenciale që kryesisht kanë të bëjnë me persona me aftësi të veqanta, në kuadër të kësaj janë të destinuara afër 150,000.00E, në kuadër të kësaj shume janë të ndara pjesa e investimeve kapitale, ndërsa pjesa tjetër për investime të tjera. Çdo shpenzim që bëhet me atë kod dhe nëse nuk janë shpenzuar për atë projekt por janë shpenzuar parat ajo paraqitet prap me atë kod. Ato 50,000.00E të shpenzuara ose janë marrë nga përmbartuesi ose janë shpenzuar janë ridestinuuar.

Drejtori për Buxhet dhe Financa-Blerim Thaçi: Ju përgjigja dhe Labinotit kemi pasur lënd përmbarese prej të gjitha kategorive, janë gjëra që nuk të pyt se nga i merr dhe thash kemi pasur vendim nga asamblea për ndërrim destinim.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: E mbylli debatin për këtë pikë të rendit të ditës, dhe vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës e cila është:

Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të Komunës së Malishevës për vitin financiar të përfunduar më 31 dhjetor 2023.

A ka diskutim për raportin e auditimit?

Urdhëro, Veton Zogaj!

Veton Zogaj (anëtar nga VV): Më mirë me diskutu vonë se kurr këtë raport, sepse ka shumë gjetje në këtë raport. Gjetje që ndikojnë në raportin e auditimit nënvlersim të llogarive të arkëtueshme shuma e përfshir këtu është 862,528E, pra llogarit e arkëtueshme nuk ishin raportuara për periudhën 2019-2023 vazhdimisht e kemi diskutuar këtë në kuvend. Më kujtohet një arsytim që na ka dhënë profa ku nuk ka qenë zyrtarja e cila ka menagju me sistemin e-pasuria. Pasurit e blera gjatë vitit nuk u regjistruan në sistemin e-pasuria dhe nuk përfshihen pasqyrat financiare. Pra 240,605.00E investime kapitale të cilat nuk figurojnë të regjistruara si pasuri të Komunës, ndërsa shuma buxhetore 240.000E është shpenzuar.

Klasifikimi jo adekuat i shpenzimit shuma e përfshir është 170,050E.

Pagat dhe mëditjet të pa paguara nga kategorit e investimeve kapitale 65,000E.

Shpenzimet e pa paguara nga kategorit e papërshtatshme të subvencionimit dhe mallrave 105,000E.

Një gjetje tjetër Procedurat e prokurorimit pa fonde të mjaftueshme e kemi cek disa herë në kuvend përshkrimi i projekteve të kontraktuara pa buxhet të mjaftueshëm shuma është 8,277,887E bëhet fjalë për projektin e parkut të qytetit. Është bërë projekti pa zotim të mjeteve. Dobësi në menagjimin e projekteve në prokurorim, 6 kontrata të mëdha nuk janë menagjuar dhe arkivuar në sistemin e platformës elektronike të eprokurorimit.

Vonesa në mbylljen e avanceve për udhëtime zyrtare shuma përfshir 5,503E, avancet nuk janë përmbyllur mbrenda afatit 15 ditë siç e thotë ligji.

Zotimi i mjeteve dhe urdhër blerjet jo sipas rregullave financiare, shuma 2,348,295E, zotimet dhe urdhër blerjet janë bërë pa pranimin e mallit.

Pagesa të projekteve nga buxheti i projekteve tjera, fonde të ndara për projektet e renovimit të ndërtimit u përdoren për projekte të tjera për miratim. Më kujtohet që i keni cekur disa her disa projekte të vitit 2018 të cilat janë bartë në buxhet dhe nuk janë realizuar kurr ndërsa mjetet e tyre janë bart.

Vonesa në fakturën e paguar shuma 82,738E fakturat nuk janë paguar brenda afatit 30 ditor.

Mungesa e projektit ekzekutiv si pjesë e specifikave teknike tenderi për rregullimin e parkut Mirusha nuk përfshihet në ekzekutiv.

Logjistika pa depo të furnizimit.

Mos mbyllja e investimeve në vijim dhe mos inventarizimi i pasurive. Projektet e përfunduara për vitin 2018 mbesin të pa regjistruar në pasurit aktive mungesa e komisionit për inventarizim të pasurive.

Dobësi në menagjimin e llogarive të arkëtueshme shuma 2,968.766E buxheti në tatimin në pronë

taksat nuk u mblodhën sipas rregullave, këtë është mirë me na spjegu qfarë dispozita ligjore nuk i kanë pëlqyer në inkasimin e taksave Komunale.

Rekomandimet në fund janë

Forcimi i kontrollave të mbrendshme

Menagjimi i fondeve publike

Rritja e efikasitetit në arkëtim.

Planifikimi dhe raportimi i saktë financiar.

Kryesusi i kuvendit-Argjend Thaçi: Urdhëro, Burim Paqarizi!

Burim Paqarizi (anëtar nga PDK): Dua të vazhdoj me qështjet të cilat kanë ndiku që raporti i auditorit me qenë i pakualifikuar, besoj që na penalizon për grantin qeveritar. Një qështje shqetësuese është bartja e projekteve vit pas viti gjë të cilën e kemi potencu në shumicën e seancave.

Rregullorja për raportin financiar, të hyrat e detyruara, të hyra të mbledhura në shumën e fakturave të pa arkëtuara. Të pa arkëtueshmet shpalosen në raportin vjetor që në tabela. Është dhe një gjetje tjetër në 5 raste Komuna ka hyr në obligime kontraktuale pa fonde të mjaftueshme. Kjo është kur ne planifikojmë me bërë investime kur nuk kemi fonde të mjaftueshme, kjo neve na penalizon me shumicën e projekteve aktive që bartja e mjeteve të ridestinohet në projekte të caktuara.

Projekti i ndërtimit të sheshit, kemi dhe kodin buxhetor për rregullimin e korrektorit kryesor të ujrave të zeza që është shumë shqetësuese për të gjithë neve.

Projekti “Ndërtimi i rrugëve kanalizimi fekal, atmosferik, ndriqimi në qytetin e Malishevës” është kontraktuar në vitin 2023 në vlerë 1,099,000E ndërsa fondet e buxhetuara për tre vite ishin 590.000E, domethënë kemi planifiku investim 50% më pak para se që duhen për me përfunduar një projekt.

Projekti “Rregullimi i parkut në Mirushë” – faza e parë ishte kontraktuar në vitin 2023 në vlerë 298.000E ndërsa për tri vite ishin 448,521E (për vitin 2023 me vlerë zero euro, për vitin 2024 në vlerë 198,521E dhe për vitin 2025 në vlerë 250,000E). Përveq kësaj kemi vërejtur se edhe para inicimit të procesit të prokurorimit nuk është bërë zotimi i fondeve të vitit aktual. Hyrja në obligime pa siguruar fondet e nevojshme, ndikon në rritjen e obligimeve të papaguara, apo implikimet buxhetore për vitin aktual, si dhe ngarkes për buxhetin e vitit vijues. E kam një pyetje për profen nëse jo sot në seancat e radhës është mirë me parë një pasqyr se sa ka borgje Komuna e Malishevës, apo sa është në obligime në raport me kompanit të cilat kanë përfunduar punët apo janë duke përfunduar punët në projekte në vazhdimësi. Raporti i auditorit po tregon që ki një keq menaxhim dhe një keq planifikim të buxhetit.

Kryesuesi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Drejtor Blerim Thaçi!

Drejtori për Buxhet dhe Financa-Blerim Thaçi: Faza e kualifikimit të raportit janë tri pika kryesore dhe atë që e ceke fitimi i performancës, këtë pasuri e kemi marrë këtë vit nuk jemi vetëm Komuna e jonë edhe po të ishin të gjitha në rregull ne nuk kemi pasur me u kualifiku. Është shqetësuese dhe kemi bërë kërkes që të largohet si kriter qështja e lëndeve përmbartimore të shujtat për mësimdhënës kjo do të jetë dhe në vitin e ardhshëm, shpresojm që nuk do të ndodhë por do të ndodhë. Jemi pregaditur që do të dal i kualifikum me të vetnen arsye se rreth

1,200,000E janë lënd për shujta të mësimdhënësve dhe ne e dimë se nëse e kalon 1% e buxhetit shuma e lëndëve përmbartimore ai raport del i kualifikum. Baza e kualifikimit është dhe prezantimi i llogarive të arkëtueshme të cilën e ceki Vetoni, arsyetimi të cilin e kam dhënë është te qështja e pasurive jo kapitale të e-pasuria mungesa e zyrtarit që nga viti 2020 kemi pasur vështirësi, probleme me munges të zyrtarit dhe për herë të parë këtë vit është caktuar zyrtari na është dashur me bërë kërkes dy apo tre muaj për trajnim, ka shkuar zyrtari është trajnuar pastaj është kërkuar trajnimi i tre depoistëve sepse nuk mund të regjistrohet e-pasuria pa pranimin e mallit prej depoistëve nga arsimi, administrata dhe shëndetësia dhe këtu është kërkuar trajnim i veqant. Jemi në procedur të furnizimit me printer të posaqëm për depoist të cilët janë caktuar për pranimin e mallit. Ndërsa te prezantimi i llogarive të arkëtueshme prej vitit 2019-2023 është një qështje jo e gabimit por e lëshimit teknik sepse gjithmon jan prezantuar obligimet këto qështjet e banimit, qështjet rezidenciale janë tatu vetëm objektet dhe pronat apo trualli ndërsa nuk janë evidentuar ngarkesat që janë tani dhe për prona bujqësore. Dhe pasi e kan evidentuar auditort ne kemi prezantuar obligimin si obligim, vetëm nuk ka hyrë në sistem, nuk e kanë pranuar si të mirëqenë, edhe e kan marrë si kriter me paraqit në raport të auditimit. Qështja e tretë keq klasifikimi është qështja të cilën e ceka te lëndët përmbartimore lëndët e mësimdhënësve.

Veton bërë pyetje te siguria e mjeteve ju e dini se çdo vit vjenë aprovim buxheti korniza afat mesme buxhetore dhe kur ka filluar ky projekt ka filluar në fund të vitit 2022, dhe tani për herë të parë këtë vit disponueshmëria e mjeteve dhurohet me një arsyetim. Ne sot kemi nënshkrur disponueshmërin e mjeteve me arsyetim me fillu me procedura. Arsyetimi është nëse mjetet në 2024 nuk ka duhet ta jep arsyetimin se janë 2025-2026-2027, atëherë nuk ka qenë me arsyetim dhe ne e kemi dhënë disponueshmërin e mjeteve mbi bazën e planifikimit tre vjeçar për kontratën e sheshit. Ne e kemi prezantuar para auditorëve, sepse e kemi një auditim të veqant për këtë dhe ata janë pajtuar në formën se si e kemi prezantuar, ata kanë pasur shqetësimin që ne do të hyjmë në obligime pa e përfunduar kontratën dhe do të mbetet projekti pa u përfunduar. Kur e kemi prezantuar që kjo në vitin e ardhshëm dhe pse kemi deri në vitin 2026 përfundon në kontrat, ne do ta përfundojmë në vitin e ardhshëm projektin e sheshit. Nuk është asnjë projekt që nuk janë të siguruar mjetet që nuk do të realizohen, sepse kur e kemi aprovuar buxhetin këtë vit ka pasur dhe projekte të reja.

Pajtohem me Labinotin që e ceki që kemi një përqindje jo të madhe të projekteve të reja, për vetë faktin që kemi obligime të kontratave të mëhershme, sikur po të mos kishim pjesë të mjeteve për kontrata që jan obligim projektet e reja të cilat i kemi prezantuar ministria na i kishin vendos në rezerv, që i bjen që nuk mundesh me buxhetu projekte të reja nëse ti nuk ke mundur me i mbulu projektet e kontraktume. Sa kemi obligime, kemi sa kan afat kontratat. Ne parashohim ti përmbyllim të gjitha kontratat të cilat janë të kontraktuara ndërmjet operatorëve dhe komunës tonë.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon Mazreku!

Valon Mazreku (anëtar nga Nismasocialdemokrate): Qështja e raporteve të auditimit në nivel komunal është përtej agjendes normale, agjend politike duke pasur parasysh se të gjitha komunat kanë probleme me kontrata të cilat nuk i ka nënshkruar komuna, janë institucionet qendrore të cilat e kanë bërë një veprim të tillë dhe si rezultat buxheti për rezultimin e këtyre kontratave

është marrë nga komunat dhe të njëjtat janë sanksionu me raport të auditimit dhe pse ekzekutimin e tyre e ka bërë niveli qendror. Për mendimin tim kjo është qështje politike sepse gjithë komunat e Kosovës udhëhiqen nga partit të cilat nuk kanë qenë në pushtet.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Veton Zogaj!

Veton Zogaj (anëtar nga VV): Valon të njoh për ekonomist por kur të flasësh duhet me pas argumente. Kush i ka nënshkruar këto kontrata. E ka nënshkruar Asim Bajrami, nuk është ky vitë apo prej qeverisjes Kurti por zbatueshmëria e kësaj kontrate është vitë për vitë prej kur ekziston kontrata kolektive. Minsitrja Nagavci e ka shfuqizuar këtë Kontrat, tani qka është duke ndodhë është duke ndodhë deri në vendimin kur është shfuqizuar kontrata, kanë e ka kapur ajo pjesë janë duke u ekzekutuar, mbas ati vendimi nuk ekziston kjo gjë.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Ju falenderoj për kontributin për këtë pikë të rendit të ditës, vazhdojmë me pikën e radhës e cila është:

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 01/429 datë: 29.10.2024 për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës publike, konform vendimit të numrit të kuvendit nr.02/121 datë: 08.03.2024. për këtë pikë të rendit të ditës a dëshironi me hap debat apo dëshiron me marrë fjalën Kryetari i komisionit të grupit punues.

Urdhëro, Muharrem Morina!

Zyrtar ligjor-Muharrem Morina: Përshëndetje për të gjithë!

Ju e dini që me vendimin nr.02/121 datë: 08.03.2024 komuna ka marrë vendim me të cilën e ka hapur procedurën vendimin preliminar me dhënë në shfrytëzim afatgjatë 99 vite disa prona publike. Vendimi është miratuar në asamble, është përgaditur dhe ka shkuar në minsitrin e pushtetit lokal për konfirmim të ligjshmëris. Në të njëjtën seanc janë formuar dy komisione të cilat janë të obliguara me ligj, komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e pronave publike në rastin e dhënies në shfrytëzim konform këtij vendimi dhe Komisioni i ankesave. Në afatin ligjor Ministria ka kthyer vetëm Komisioni i ankesave e ka konfirmuar ligjshmërinë që është në pajtim me ligjin. Komisionin për shqyrtimin dhe vlerësimin e dhënies së pronave në kohë afatgjate nuk e kanë kthyer, dhe vendimin e asambles për dhënie në shfrytëzim nuk e kanë kthyer konfirmimin e ligjshmëris. Afati ligjor që ministria ka për ta kthyer konfirmimin e ka 15 ditë kalendarike, dhe mbas këtyre nëse nuk e kthen konfirmimin vendimi hynë në fuqi mbas votimit në asamble. Me datën 20.08.2024. 6 muaj mbas këtij vendimi komisioni e ka filluar punën e tyre e ka përgaditur lokacionin e nevojshëm, e ka përgaditur thirrjen publike e cila mban nr.02/357. Në këtë thirrje komisioni pas një pune 6-7 mbledhje që kemi pasur ku pjesë e Komisionit ka qenë Halil Morina, Eqrem Morina prej shoqëris civile kanë qenë Adrian Mazreku ndërsa nga ekzekutivi kanë qenë unë dhe Drejtori për Kulturë Fitim Shala. Kemi hapur procedurën me thirrje publike me datën 20.08.2024, dokumentat të cilat ju i keni, pastaj mbas afatit 15 ditor i kemi shqyrtuar ofertat në Komision është përgaditur raporti të cilin e keni ju. E kemi pasur vetëm një ofertë nga Kompania "B-Famis shpk" në Suharek. Mbi bazën e këtij njoftimi publik, thirrjes dhe vendimit të asambles Komisioni ka përgaditur një raport të cilin e keni ju, në raport është përmbledh e gjithë puna e këtij Komisioni, që nga hapi i parë se si ka ardhë formimi i Komisionit, takimet të cilat janë mbajtur, thirrja publike, njoftimi publik, aplikimi i kompanisë dhe në fund raporti është bërë në formën e shkruar para jush. Është autoriteti juaj me vendos në procedurë të dhënies në shfrytëzim afatgjatë

të parcelës të cilën e kemi përcaktu për me dhënë sipas vendimit 02/121. Oferta është e bërë në tri variante, variant i parë është 32% e ndërtesës që e planifikon investitori me ja dhënë komunës, në bazë të thirrjes ne e kemi caktu qmimin minimal apo vlerën minimale 30%, 1,600,000E vlera e tyre e të cilën vlerë financiare operatori i ka ofru komunës që mundet me përfundu projektin publik ndërtimi i sheshit rreth Lumit dhe ndërtimi i kanalizimit varet si e përcakton Komuna e Mishevës.

Këto janë tri opsionet e ofertës që i ka ofru komunës, është autoriteti juaj që vendos në procedur të mëtejme nëse dëshironi me miratu, doni me u përcaktu pastaj vendimi juaj kompletohet me gjithë shkresat e lëndës të cilat janë procedu deri më tani. Pas miratimit apo pas pozicionimit të ministrit në këtë procedur vjenë nënshkrimi i kontratës. Së bashku me Halilin, Egremin, Fitimin jemi munduar maksimalisht me i përfillë procedurat ligjore të ligjit për dhënie në shfrytëzim të pronës publike por dhe të rregullores së qeveris për dhënie në shfrytëzim të pronave publike. I gjithë dokumentacioni ka qenë transparent, është publiku në media në Facebook faqe të Komunës në të gjitha mundësit që i kemi pasur, në atë qka e kërkon rregullorja i kemi plotësuar kriteret proceduriale, në aspektin vendimarrës është kompetencë e juaj me vendos formën se si do të vazhdohet më tutje.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Veton Zogaj!

Veton Zogaj (anëtar nga VV): Arsyeja që unë kërkoja me u larguar prej rendit të ditës kjo pikë janë shumë të detajuara në vetë raportin e Komisionit njoftimin publik që e ka bërë për dhënie në shfrytëzim të pasurisë së paluajtshme. Nëse e shohim njoftimin publik të datës 01.10.2024 thuhet kështu Njoftim publik Komisioni duke vepruar në harmoni me rregulloren e lartë cekur dhe evidentimin e dokumentacionit ka konstatuar që kemi hasur vetëm në një ofertë sipas thirrjes publike që mban numrin e protokollit të datës 20.08.2024. Kompania ofortuese "B-famis" me seli në Suharek. Përshkrimi i ofertës hapsira e ndërtimit është 15,350m². Vlera e investimit kompleksi afarisor-banesor 5,000,000E do të investoj.

Oferta e operatorit për Komunën e Malishevës nga operatori siç e cekim dhe Muharremi oferta parë është 32% ndërtesës që e planifikon investitori me ja dhënë Komunës, afati i realizimit të këtij është 30 muaj.

Oferta e dytë ndërtimi i rrugës me trotuar nga ura e qytetit deri te ura e tranzitit së bashku me rrënimin e objektit të sahat kullës dhe Muzeut që është në vlerë afër 1,600,000E dhe oferta e tretë ndërtimi i kanalizimit sipas nevojës së komunës varësisht nga kërkesa e investitorit në vlerë prej 1,600,000E. Pasi që është Drejtori Avdi, kërkoj disa sqarime sepse ne si subjekt politik mendojmë që këtu ka aferë korruptive në këtë që po tentojnë me ju dhënë dhe kërkojnë pajtimin e secilit asambelist. Kam biseduar dhe me ekspert të ndërtimit janë në pyetje 15,880m². Keni me rrënu një objekt që është momental që i ka kushtuar Komunës së Malishevës 350,000E.

Sipas ekspertëve të ndërtimit me kompetencë nëse më kanë gënjyer ata mua, po ju gënjëj dhe unë juve ky objekt me këto metra² kushton 314,861.00E pa marrë parasysh qmimin e tregut. Qështja e tretë ju ka dhënë tri oferta dhe qmimi i gjithë ofertave e ka një qmim 1,600,000E i përfiton Komuna. Ndërsa nëse e marrim investimin 5,000,000.00E dhe komplet shitjen e objektit në qendër të qytetit e kam kalkuluar me minimalin e qmimit pra 15.880m² nëse i shet kompania e cila e ndërton objektin ka 750E me vlerën minimale i bjen 11,910,000.00E që i fiton Kompania. Kur ka filluar projekti na është thënë nga Drejtori Avdi dhe nga Kryetari që projekti do të shkojë

deri te lumi hapsir publike. Do të ndërtohet një rrugë që del te kafet andej ka ura dhe me atë ide është zgjeru dhe ura e lumit. Kush ka tokë mundet sot me bërë marrveshje individuale me kompanin, por në qendër të objektit me u rrënuar një objekt dhe me ndërtuar banesa, ne këtë nuk e kalojmë me lehtësi kjo përmban dëm për prokurorin dhe për organet e hetuesis ne kemi dyshime të bazuara ata leta dhëjnë verdiktin final. Unë i ftojë kolegët asambleist me luftu, ne si grup nuk marrim pjesë e lëshojmë seancën dhe kërkojmë të evidnetohet në procesvërbal nuk bëhemi pjesë e këtij pazari.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Faleminderit Veton! Urdhëro, Halil Morina!

Halil Morina (anëtar nga Nismasocialdemokrate): Sa i përket kësaj pike të rendit të ditës e kam cekë kur është marrë vendimi fillestar për dhënie në shfrytëzim të këtyre pronave, është shumë e rëndësishme institucionet publike me thur mbrenda vete kapitalin privat. E vetmja mënyr e zhvillimit të ekonomis është bashkëpunimi i institucionit publik me atë privat. Ne kemi një sër pronash në shfrytëzim, e sot kemi me diskutu vetëm për këtë pronën prej 20ari, me të cilën për momentin është sahat kulla dhe ish objekti i drejtoris për punë sociale. Ligji ja jep të drejtën Komunave me i dhënë pronat e veta në shfrytëzim për 99 vite. Kemi parasysh rritja e vlerës së pronës, zhvillimi ekonomik, interesi i Komunës dhe interesi përgjithshëm qytetarë. Sot ajo pronë për të cilën ne po synojmë me dhënë në shfrytëzim nuk e ka pothuajse asnjë vlerë, nuk përfiton as Komuna as qytetarët. Përmes këti propozimi për dhënie në shfrytëzim përfitojnë shumë palë, Komuna e Malishevës përfiton 32% të vlerës së investimit. Këtu përfiton Komuna jo vetëm në vlerë me 32%, këtu ndërtohet një objekt afarist-banesor ku ato njësi për banim dhe njësi afariste kanë me pagu tatim në pronë, ato biznese që hapen kanë me pagu taksa. Ka me u rrit punësimi është fitim i shumë anshëm i dhënies në shfrytëzim të kësaj prone. Ne ja kemi vendos minimum 30%, ne kemi prit që ka me pas më shumë aplikues por ishte vetëm një dhe ai ka shpreh interesimin më shumë se ne që e kemi vendos minimalen. Nëse ne sot e dhëjmë në shfrytëzim këtë pronë ka përfitim dhe Komuna, do të i ngritet vlera kësaj prone, do ta nxit zhvillimin ekonomik, do të rritet punësimi.

Unë kërkoj nga ju me shiku në këtë formë sepse kështu vendet e përparume demokratike janë zhvillu. Kjo kompani që ka apliku e ceki dhe Kryesusi i komisionit Muharremi i ka paraqit tri verzione me marrë 32% të hises së këti investimi, ose me u reaalizu në vlerë të kësaj projekti rreth lumit ose projekti i tret që ne ta kanalizojmë aty ku ka nevojë. Nëse ne e zgjedhim 32% me marrë hise ne nuk kemi të drejt si Komunë me i shit ato banesa, ne nuk mundemi me i shëndrru në banesat e banimit social, sepse banesat e banimit social i kemi ndërtu në pjesë tjetër. Unë konsideroj që ëshë më livërdi për ne në vlerë të kësaj përqindje që i bie 1,600,000E me u realizu projekti i trotuarit dhe asfaltimi rreth lumit. Po flas në emër të grupit të Nismës Social demokrate jemi pro të dhënies në shfrytëzim të kësaj prone, dhe ne jemi pro me zgjedhë ofertën e realizimit të projektit të asfaltimit dhe trotuarit rreth lumit.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon Mazreku!

Valon Mazreku (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Pa dashur me repliku kolegun por diku deri në 350E kushton një metër² me ndërtu një ndërtes, nëse e ki tokën tënde, por nëse të vyn për me fitu dhe 30% të pjesës së pronarit të tokës kjo vlerë mundet me shku deri në 450E si kosto që i atribuohet investitorit. Mirë e ceki Halili që secili biznes apo secili synim i të bërit biznes në

radhë të parë e ka fitimin. Sa i përket atyre 3 ofertave të cilat janë prezantu dhe i prezantoj Muharremi e falenderoj për elaburimin shumë të kapshëm. Konsideroj që qështjet e kanalizimit ne i kemi disa kontrata të cilat janë të nënshkruara dhe janë në proces të implementimit për rregullimin e disa segmenteve të kanalizimit.

Sa i përket pjesës së pjesë marrjes në objekt mënyra se si kanë me u trajtu ato për mendimin tim është pak e pa qartë duke pasur parasysh që kjo pronë nuk po shitet por po dhurohet në shfrytëzim për një afat që është 99 vite. Kisha propozu që të gjithë ata që mendoj që janë pro këtij veprimi, këti aktivitetit me mbështet pjesën e rregullimit të shtratis të lumit. Mirëpo u cekën aty 650m deri në 700m e di saktë që prej urës së qytetit deri te ura e tranzitit vetëm me shku janë 650m ndërsa dhe me u kthy janë 650m, a është e përfshir komplet të dy vijat apo si vijë e plotë sa i përket komplet si projekt i shtratis lumi me u rregullu. Këtë ndoshta na shpjegon Muharremi. Nëse e mbani në mend përafërsisht në vitin 2010 është rregullu shtrati i lumit pastaj është deformu sepse nuk jan respektu vijat e shtratis sipas ndarjes gjeodezike të cilat janë bërë me shpronësim dhe si rezultat një pjesë ka qenë e devijume dhe kur është dashur me u hap si rrugë aty ka pasur pengesa dhe ka hasur në pronë private. Tani projekti që është duke u rregullu është vendos shtrati pikërisht siq janë vijat gjeodezike të cilat e krijojnë hapsirën për të dy anët e lumit me pas dhe rrugë dhe trotuar për këmbësor. Kjo ishte që më interesoj a është e përfshime komplet apo vetëm 650m si vij e drejtë?

Zyrtar ligjor- Muharren Morina: Nëse e sheh thirrja publike kur është bërë thotë Komuna e cakton projektin, është si vlerë financiare a do të bëhet komplet apo vetëm një pjesë në të dyja anët në vlerë 1.600,000E projektin do ta bëjë Komuna.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Alban Kastrati!

Alban Kastrati (anëtar nga PDK): Më bën përshtypje ky projekti i lumit a bën mem tregu sa herë ky projekt është rregullu me taksa të qytetarëve dhe prap është rrënuar?

Dhe a dini që duhet me dhënë llogari dikush për këto mjete të cilat po shpenzohen?

Këtë vit bëhet një investim 200,000-300,000E dhe mbas një viti ka gabuar gjeodezia pikat nuk kanë qenë mirë atë ditë, dhe mbas një viti po e prishim këtë investim dhe po i ndajm dhe 300,000E tjera prap po investojmë. Nuk po më duket serioze kjo punë, kjo është me bërë hajgare me pronë dhe me paran publike me taksa të qytetarëve. E ceka më herët është aset, ka vlera dhe është bërë një investim me taksa të qytetarëve sahat kulla, muzeu, biblioteka këto ja dhëjnë një pamje të bukur qytetit. Përse me i rrënu këto?

Është më e dhimbshme që mban emrin e dëshmorit "Ibrahim Mazreku". Mos bëni këso gjëra me i degradu dëshmorët, me i degradu vlerat e luftës. I bëjë thirrje shoqatave të dalura nga lufta të Komunës së Malishevës të dalin të i mbrojnë këto asete, këto vlera, këta emra, sepse pushteti nuk po sheh asgjë tjetër vetëm paranë dhe ndërtimet vetëm aty e shohin interesin dhe manipulojnë më lehtë.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Veton Zogaj!

Veton Zogaj (anëtar nga VV): Drejtor Avdi, dua të më përgjigjesh shkurt nëse ka mundësi me më tregu a ka qenë e parapame në projekt ky ndryshim sepse ku na është prezantuar neve si anëtarë të Kuvendit aty ka qenë opsionale nëse Komuna dëshiron me ndërtu ndonjë objekt afarist

mundet por nuk ka qenë. Për këtë arsye e ceka që është zgjeruar ura e lumit në mënyr horizontale. A ka marrë Komuna leje në agjensionin për menaxh imin e ujrave për ndërtimin e urës, sepse nëse nuk ka marrë leje kjo është shkelje e rënd e ligjit. Ku ruhet shtatorja e komandantit legjendar e Adem Jasharit?

Në qfarë vendi a është vend dinjitoz apo në garazhdat e kompanis e cila po ndërton?
Nëse është në depo të kësaj kompanie atëherë ju keni bërë veprën më degruse.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Halil Morina!

Halil Morina (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Nuk është mirë me shfrytëzu foltoren me disa akuza të përgjithshme, kush do që e ka atë dyshim janë organet për këtë punë. Muzeu, nuk e ka emrin e dëshmorit objekti por muzeu. Muzeun nuk jemi duke e prish jemi duke e bartë nga një lokacion në një lokacion tjetër. Kjo nuk është kurfarë përllosje as e figurave dhe as e dëshmorëve. Shtatorja e Adem Jasharit, eshtrat e Adem Jasharit ja kanë zhvendos nga një vend në vendin tjetër tani na me i thënë përllosje të eshtrave të Komandantit Adem Jasharit. Nuk është përllosje kjo, rikonstruktohet qyteti e ndryshojmë, ne e kemi rikonstruktuar komplet sheshin. Ky objekt për të cilin po flitet i cili është pa leje i ka disa probleme, konstruksioni i ri i këtij qyteti ai objekt është i papërshtatshëm nuk inkurpurohet dhe për me u zëvendësu duhet me u rrënu dhe me ndërtu një objekt që po konsiderojmë me ndërtu. Qka ka këtu përllosje, vlerë e kufitës? Qka ka këtu korrupsion? Kush do që ka dyshimin më të vogël janë organet e duhura për këtë punë. Ne vetëm po dëshirojmë me ja rrit vlerën kësaj prone për hir të interesit tonë si Komunë, për hirë të interesit të qytetarëve të kësaj Komune, për hir të rritjes së të hyrave vetanake, rritjes së numrit të punësuar të gjitha këto benefite janë që i vijnë Komunës së Malishevës nëse ne votojmë këtë. Në baz të qmimit të tregut ajo kompani private ka me investu 1,600,000E sa e zgjatë a e bënë në një anë apo vetëm njërën ai ato para do të i investoj aty. Qysh kemi me u zhvillu ndryshe ne si Komunë nëse nuk e ftojmë biznesin privat, për ne kompanit e këti vendi nuk janë armiq e këti vendi. Armiq e këti vendi janë ata që dëshirojnë me pa popullin e varfër me qenë në zor për 100E deri të ja qet në fund të vitit. Ne nuk jemi ashtu, biznesi për ne është një partner shumë i rëndësishëm, bizneset kompanit janë që e mbushin këtë vend me taksat e tyre. Nëse dikush ka dyshime që këtu është duke u bërë një pazar apo dallavere tregona dhe neve se qështu është duke dashur të luhet loja. Mos të i përdorim emrat e dëshmorëve këtu sepse nuk ka të bëjë kjo punë me emra të dëshmorëve. Ne po dëshirojmë me rregullu këtë shesh me qëndru më mirë përmendoret e busat e dëshmorëve tanë qoftë të Komunës tone, qoftë të Komandantit legjendar "Adem Jasharit".

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Labinot Gashi!

Labinot Gashi (anëtar nga LDK): Kur është bërë vendimi, vendimi i objektit ka qenë opsional kur është bërë prezantimi i sheshit na është thënë që nëse do të bëhet do të bëhet për zgjerim të sheshit, për lirim të hapsirave publike. Askush nuk është kundër bizneseve të qështja e pronës duhet me qenë shumë të ndishëm, unë nuk e di që ka ardhë ndonjë biznes me investu këtu për arsye të atmosferës së punës këtu. Ka pasur disa tentative në mandatin e kaluar Muharremi e dinë janë tërhek me probleme por nuk kemi pasur asnjë investim serioz. Po bazohem në të kaluarën prej përvojës personale timen që e kemi pasur në këtë asamble, ne i kemi Xrastet të pronave publike të Komunës me vjetë të tëra të dhëne në shfrytëzim, dhe nuk e dimë a ka përfitu ndonjë

cent komuna a jo. Për mua nuk e paski mendu mirë në qendër me ndërtu banesa kemi nevojë për hapsira gjelbëruese, dhe ai është objekt publik dhe janë një varg institucionesh që punojnë. Afër 400,000.00E ka kushtuar Muzeu. Në qendër të Malishevës nuk besoj që na duhet një objekt aq i madh në qosh të sheshit. Dhe pika tjetër lidhet me qështje të pronave, arsyetimin asnjëher nuk po na bëni si duhet, ose na jepni me vonesë arsyet, qëllimin, kush është mbas këtyre nuk e di. Nëse dëshironi me emër ju ceki është pjesë e komunës 100 probleme i kemi pasur dhe asnjë cent komuna nuk ka fituar nga objektet e tjera.

Veton Zogaj (anëtar nga VV): Këtu po ka tendencë çdo herë prej partis në pushtet që me i deviju ato qka po i flasim ne dhe po ka qëndrime kontrast, po mendojnë që ne nuk po jetojmë këtu. Siç e dini nuk e kemi votuar këtë projekt por me gjithë atë e kemi mbështetur fuqishëm kur ka filluar kryetari iniciativën për lirin e hapsirave publike. Ne i kemi liru disa hapsira publike por dëshirojmë në mes të sheshit me bërë një objekt gjigant se po i duhet komuna me i fitu 1,600.000E. Tregona sa i keni borgj kësaj kompanie që nuk keni mundur me i kry obligimet dhe tani po duhet me i hy këti pazar.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon Mazreku!

Valon Mazreku (anëtar nga Nismasocialdemokrate): Jemi në një situatë secili e ka atë verzionin e vet të mendimit, mirëpo aq mirë e ka artikulu Halili me Muharremin që interesi i komunës është përtej një objekti banesor afarist të gjitha këto njësit banesore, lokalet për 99 vite ato janë të hyra të sigurta tona. Nga një zonë e baltosur po kthehet në një zonë kur ki me pas vullnetin maksimal me qëndru aty ti qohesh dhe thua jam kundër kësaj kjo është me u habit. Zhvillimet më të mëdha të ekonomisë kanë ndodhë pikërisht prej sektorit privat, e në veqanti prej vetë punësisimit. Tani liberalizimi i vizave është bërë dilni pak shihni se si janë zhvilluar vendet, dilni nga paketa.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Agnesë Kastrati!

Agnesë Kastrati (anëtare nga VV): Nuk desha të ndërlihem në debat sepse qëndrimet tona i dha shefi i grupit tonë, por po është e pa mundur vetëm me i ndëgju dilni shihni pak, dilni prej paketës, shtesat për fëmijë, shtesat për lehonë, po dëshironi me i mbajt njerëzit të varfër me i dhënë vetëm nga 100E. Të paktën nga Halili kam mendu që e din qka janë shtesat univerzale për fëmijë, nuk është qështje e lëmshës ose nëse janë ashtu edhe në Gjermani dhe kudo po i dhurojkan kështu lëmsh. Halili më bëri përshtypje kur tha që Muzeu nuk inkurpurohet në kuadër të këti projekti të sheshit. E kemi një objekt i cili është pa leje kurr nuk kemi pasur sqarime kush mban përgjegjësi për atë vlerë që ka kushtuar. Si me votu ne kur e kemi një objekt që nuk po inkurporohet dhe tani me votu një objekt që nuk e dim si ka me u dok dhe si ka me u inkorporu. Nuk po mundemi me imagjinu si ka me u dok, thjesht nuk e kemi një projekt në vija më të gjera si duket ai objekt. Vetëm po e dimë që ka me u ndërtu te sahat kulla. Valon Mazreku të gjithë kemi dalur dhe dimë.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: E mbylli debatin për këtë pikë të rendit të ditës dhe e hedhi në votim.

Sallën e liruan grupi i VV-së dhe PDK-së.

Në mungesë të kourumit mbledhjen e vazhdojmë të Hënën në ora 10:00.

Vazhdimi i mbledhjes së shtatë të rregullt të KK të Malishevës.

Datë: 30.12.2024.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Përshëndetje për të gjithë!

Mirë se keni ardhur në vazhdimin e mbledhjes së shtatë të rregullt të KK të Malishevës. Po vazhdoj me pikat nga mbledhja e kaluar të pranishëm jemi 17 anëtarë të Kuvendit dhe kemi kourum për vazhdim të punimeve. Kemi mbetur te pika e 4 që e kemi përfunduar debatin kërkoj nga ju që të i hedhi propozimet sepse nga oferta ishin tri propozime dhe ne duhet ta zgjedhim një propozim.

Urdhëro, Halil Morina!

Halil Morina (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Përshëndetje për të gjithë!

Debatin për këtë pikë të rendit të ditës e kemi përfunduar, grupi i Nismës Social Demokrate voton pro kësaj oferte meqë ne kemi vetëm një ofertë dhe kjo ofertë ka mbrenda tri propozime, ne si grup i Nismës propozojmë që të votohet oferta e dytë që është ndërtimi i rrugës nga ura e qytetit deri te ura e tranzitit me gjatësi 650-750m2 së bashku me rrënimin e objektit të sahat kullës dhe muzeut të qytetit në vlerë prej 1,600,000E.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Nëse nuk ka askush tjetër e hedhi në votim propozimin e Halilit. Kush është për propozimin e Halilit që në kuadër të pikës së 4 të kërkesës nr. 01/429 datë: 29.10.2024 për dhënie në shfrytëzim afat gjatë të pronës publike sipas vendimit të Kuvendit nr. 02/121 datë: 08.03.2024, kush është për?

Për: 14

Kundër: 1

Abstenim: 2

Me 14 vota për, 1- Kundër, 2-Abstenime miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Vazhdojmë me pikën e 5. Shqyrtimi dhe miratimi i listës së pronave të paluajtshme të Komunës. Nga lista që kemi në material a ka ndonjë pronë që pretendon që është në interes potencial të Komunës për të qenë në kuadër të listës së pronave në shfrytëzim.

Urdhëro, Valon Mazreku!

Valon Mazreku (anëtar nga Nismasocialdemokrate): Duke e marrë parasysh që kjo listë është një aprovim preleminar që do të thotë të gjitha ato prona të cilat janë në kuadër të listës duhet një vendim i veçant për secilën nga kuvendi besoj që gjithqka është në rregull.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Nëse nuk ka askush për diskutim, e hedhi në votim kush është për miratimin e pikës 5?

Për: 14

Kundër: 1

Abstenim: 2

Me 14 vota për, 1- Kundër. 2- Abstenime miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Të nderuar anëtar të kuvendit ne në ora 12:00 duhet të dalim në pauz për arsye se salla është e nxëne për arsye të një aktiviteti që e kanë shoqatat e dalura nga lufta. A dëshironi të vazhdojmë pas pauzës me pikat e rendit të ditës apo dëshironi të vazhdojmë deri në kohë të pauzës.

Urdhëro Halil Morina!

Halil Morina (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Unë kisha kërkuar që të i trajtojmë kërkesat e qytetarëve dhe vazhdojmë me pika tjera deri sa premtan koha të vijë përfaqësuesit e shoqatave. Pikat e tjera të bartën për mbledhjen në Janar.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Atëherë vazhdojmë me pikën e radhës e cila është pika e 6 shqyrtimi dhe miratimi i planit komunal për menaxhimin e mbeturinave. Nuk e kemi askënd me prezantuar këtë pikë të rendit të ditës. Urdhëro, Halil Morina!

Halil Morina (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Ne e kemi marrë këtë material me kohë e kemi parë që kjo rregullore mbështetet në ligjet në fuqi, unë ju besoj atyre të cilët kanë qenë në Komision kështu që pa asnjë dyshim apo propozim po e votojmë ashtu siç komisioni e ka punuar.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Kush është për miratimin e pikës së 6 shqyrtimi dhe miratimi i planit komunal për menaxhimin e mbeturinave.

Për: 16

Kundër: 0

Abstenim: 1

Me 16 vota për, 0- Kundër, 1- Abstenim miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Pika e radhës është: Shqyrtimi dhe miratimi i draft- Rregullores për Transparencë në Komunën e Malishevës. E kemi këtu zyrtarin për informim z. Artan Paqarizi!

Artan Paqarizi: Përsëendetje për të gjithë!

Kjo Rregullore është mbështet në ligjin për vetëqeverisjen lokale në pajtim me udhëzimin administrative për administratë të hapur në komuna, si dhe Statutit të Komunës. Kjo Rregullore i ka përfunduar të gjitha procedurat sipas ligjit nëse keni pyetje ju përgjigjem.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Nëse nuk ka pyetje e hedhi në votim pikën e 7 shqyrtimi dhe miratimi i draft- Rregullores për Transparencë në Komunën e Malishevës. Kush është për?

Për: 14

Kundër: 0

Abstenim: 3

Me 14 vota për, 0-Kundër, 3-Abstenime miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Vazhdojmë me pikën e 8 formimi i Komisionit për hartimin e planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2025.

Bazuar nga praktikat e kaluara anëtarët e komisionit kanë qenë shefat e grupeve parlamentare, Kryesusi i Kuvendit dhe dy anëtarë nga zyra e Kryetarit. A dëshironi me shku me këtë format apo keni ndonjë sygjërim tjetër.

Urdhëro, Valon Mazreku!

Valon Mazreku (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Pasi që të gjitha subjektet politike janë të përfaqësuar nga shefat e grupeve, formati siç ka qenë në vitin e kaluar nuk ka ndonjë ndryshim që e propozoj.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Kush është që anëtar të komisionit të jenë shefat e grupeve parlamentare, kryesusi i kuvendit dhe dy anëtarë nga zyra e kryetarit.

Për: 15

Kundër: 0

Abstenim: 1

Me 15 vota për, 0-Kundër, 1-Abstenim formohet komisioni për hartimin e planit të punës së Kuvendit për vitin 2025.

Pika e radhës është: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 01/942 datë: 12.08.2024 e parashtruar nga Kryetari i Komunës.

Kemi të bëjmë me një kërkesë të grupit të vullnetarëve për realizimin e projektit për ngritjen e shtatores së dëshmorit Tahir Sinanit në qytetin e Prizrenit, duke vepruar në pajtim me kërkesën nr.01/781 datë: 26.06.2024 e parashtruar nga grupi i vullnetarëve.

Të nderuar anëtarë të Kuvendit të Komunës së Malishevës duke vepruar në pajtim me kërkesën nr.01/781 e parashtruar nga grupi i vullnetarëve për realizimin e projektit për ngritjen e shtatores së Dëshmorit “Tahir Sinani” në Qytetin e Prizrenit, para jush propozoj njëherit kërkoj që ta përkrahni këtë kërkesë në bazë të mundësive buxhetore që i ka Komuna me rastin e realizimit të projekteve të tilla me karakter historik dhe kulturor, sidomos për Dëshmorët e Atdheut. për dijenin tuaj, shtatorja e Dëshmorit “Tahir Sinani” të ndërtohet në territorin e qytetit të Prizrenit, do të jetë në bashkëfinancim të shumë akterëve, mirëpo ne do të gjejmë mundësit tona ligjore, që pasi ju të vendosni për shumën e mjeteve financiare, ti orientojmë në realizimin në projektin në fjalë, por pa rënë në ndeshë me ligjin.

Urdhëro Halil Morina!

Halil Morina (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Unë kosnideroj që ja kemi borxh dëshmorit “Tahir Sinani” meqë ka pasur një shpirt luftarak dhe patriotik në zonën tonë. Sa i përket shumës meqë nuk kemi ndonjë shumë në kërkesë ndonjë shumë të caktuar që e kanë kërku, nuk kam ndonjë ide se qfarë shume mundemi me ja nda por ne si grup jemi me mbështet si kërkesë për shumë mundemi me u konsultu për pak kohë.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: 5 minuta pauz deri të formohet kourumi. Jemi te pika e 10 kërkesa nr.01/942 datë: 12.08.2024. a ka ndonjë propozim për shumën?

Urdhëro, Amrush Helshani!

Amrush Helshani (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Në emër të grupit të Nismës Socialemokrate propozojmë që të i ndahen 10,000E për ngritjen e shtatores së Dëshmorit “Tahir Sinani”.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Kush është për që shuma 10,000E të i ndahet kërkesës nr.01/942 për ndërtimin e shtatores së dëshmorit të kombit “Tahir Sinani”?

Për: 15

Kundër: 0

Abstenim: 3

Me 15 vota për, 0-Kundër, 3- Abstenime, miratohet kjo kërkesë.

Kemi tri kërkesa të natyrës së njëjt për ndërrim destinim të tokës bujqësore. Nuk besoj që ka nevojë për debat është ministria e mjedisit dhe planifikimit hapsinor ajo që e vlerëson. Kush është për miratim të kësaj kërkesë?

kërkesa nr.02/423 datë: 24.10.2024 për ndërrim destinim të tokës bujqësore.

Për: 14

Kundër: 0

Abstenim: 4

Me 14 vota për, 0- Kundër, 4- Abstenim miratohet kjo kërkesë.

Kush është për miratimin e kërkesës nr.02/465 datë: 28.09.2023 për ndërrim destinim të tokës bujqësore.

Për: 14

Kundër: 0

Abstenim: 4

Me 14 vota për, 0- Kundër, 4- Abstenim miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Kërkesa e radhës është: nr.06/299 datë: 05.12.2022 për ndërrim destinim të tokës bujqësore.

Kush është për?

Për: 14

Kundër: 0

Abstenim: 4

Me 14 vota për, 0- Kundër, 4- Abstenim miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Kemi kërkesat e radhës të cilat janë për trajtim shëndetësor. A dëshironi me i vendos komplet apo një nga një.

Zyrtar ligjor- Muharrem Morina: Nëse janë të natyrës së njëjt vendosi bllok.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Kush është për që kërkesat në vijim të ju ndahen nga 1500E për trajtim shëndetësor.

Kërkesa nr.02.430 datë: 04.11.2024

Kërkesa nr. 02/215 datë: 28.05.2024

Kërkesa nr. 02/436 datë: 06.11.2024

Kërkesa nr.02/169 datë: 03.04.2024

Kërkesa nr.01/986 datë: 05.09.2024

Me 18 anëtar të pranishëm, unanimisht miratohen të gjitha këto kërkesa.

Të ndryshme a ka dikush diqka për të shtuar?

Urdhëro Valon Mazreku!


Valon Mazreku anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Po shfrytëzoj rastin me ju uru të gjithëve festat e fund vitit, ju uroj që vitin e ri ti keni të gjitha të mirat.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Po ashtu në emër të Kuvendit urime festat e fund vitit. E mbylli seancën. Faleminderit shumë të gjithëve.

Përfundoi në ora: 11: 35

Procesmbajtësja:

Argenitë Krasniqi



Kryesuesi i Kuvendit

